



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENÇËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

POZITAT DOMINUESE NË TREG DHE ABUZIMET ME DOMINIMIN

SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË

5



Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju
Kosovo Competition Authority

**SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË
(Broshura Nr.5)**

POZITAT DOMINUESE NË TREG DHE ABUZIMET ME DOMINIMIN

Çfarë është një pozitë dominuese?

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (të ndryshuar) ¹, një ndërmarrje ka një pozitë dominuese në treg nëse, në lidhje me furnizimin ose blerjen e mallrave ose shërbimeve specifike, nuk i nënshtrohet konkurrencës së ndershme në treg dhe ka fuqi të konsiderueshme në treg në krahasim me konkurrencën ekzistuese ose të mundshme² të tij. Kjo nganjëherë njihet si pozita e "monopolit" ose gati-monopolit. Në rrethana të tilla, shqetësimi kryesor në kuadër të Ligjit është të sigurojë që një ndërmarrje me një pozitë dominuese në treg të silllet me një standard të lartë drejtësie në lidhje me konkurrencën dhe klientët e saj (d.m.th. nuk abuzon me pozitën dominuese të saj në treg).

Sipas Ligjit, një prezumim për një pozitë dominues në treg ekziston kur një ndërmarrje ka më shumë se 25% pjesëmarrje në një treg të veçantë në Kosovë. Për më tepër, dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura mund të gjinden në një pozitë dominuese (dominimi i përbashkët) nëse, ata operojnë së bashku në një treg të veçantë në Kosovë dhe nëse së bashku ata kanë më shumë se 40% të pjesëmarrjes në atë treg.

Për të vërtetuar pozitën dominuese të një ose disa ndërmarrjeve në treg, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) normalisht në raste specifike merr parasysh disa konsiderata, duke përfshirë:

- Pjesëmarrja e tij (ose e tyre) në një treg të veçantë në Kosovë;
- Natyra e qëndrueshmërisë së një pjesëmarrje të madhe në treg;
- Fuqia financiare e ndërmarrje-s/ve;
- Aktivitetet e saj (ose të tyre) furnizuese dhe në treg;
- Lidhjet e saj (ose të tyre) me ndërmarrjet e tjera;
- Pengesat për hyrje (ligjore ose tjetër) në një treg të veçantë në Kosovë;

¹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 03 / L-220) i vitit 2010 i ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 04 / L-226) të vitit 2014

² Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (I ndryshuar), neni 10.1.

- Konkurenca aktuale ose ajo e mundshme me ndërmarrje të themeluara brenda ose jashtë Kosovës.

Ndërkohë që kjo përfshin një analizë të tregut rast pas rasti, sidoqoftë, është shumë e qartë që dominimi nënkupton që një ndërmarrje dominuese të ketë aftësinë për të vepruar, në një masë të konsiderueshme, në mënyrë të pavarur nga klientët, furnitorët dhe konkurrentët e saj. Kjo do të thotë që ndërmarrja e ka kapacitetin për të rritur fitimet e saj duke rritur çmimet e saj në mënyrë thelbësore dhe të qëndrueshme.

Për më tepër, një ndërmarrje ose disa të tilla mund të hedhin poshtë prezumimin e një pozite dominuese në treg (madje edhe me një pjesëmarrje në një treg të veçantë më të madhe se 25% ose 40%) nëse ato mund të hedhin poshtë dominimin e tregut në bazë të konsideratave të mësipërme.

Dominimi i përbashkët

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura mund të jenë në një pozitë dominuese (dominimi i përbashkët) nëse, ato operojnë së bashku në një treg të veçantë në Kosovë dhe nëse së bashku ato kanë një pjesëmarrje prej më shumë se 40% në atë treg .

Në lidhje me dominimin e përbashkët, është vërejtur se:

“Në parim, nuk ka asgjë për të parandaluar dy ose më shumë subjekte ekonomike të pavarura të jenë të bashkuar në një treg specifik, nga lidhje të tilla ekonomike që, për shkak të këtij fakti, ata mbajnë së bashku një pozitë dominuese në raport me operatorët e tjerë në të njëjtin treg. Një rast i tillë mund paraqitet, për shembull, kur dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura së bashku, përmes marrëveshjeve ose licencave, posedojnë një avantazh teknologjik që u jep atyre fuqinë të sillen në një masë të konsiderueshme, në mënyrë të pavarur nga

*konkurentët e tyre, klientët e tyre dhe në fund të fundit nga konsumatorët e tyre.*³

Që dominimi i përbashkët të ekzistojë, duhet që nga pikëpamja ekonomike, dy ose më shumë ndërmarrje të paraqiten ose të veprojnë së bashku në një lloj mënyre në një treg të caktuar si një ndërmarrje kolektive. Kjo mund të ndodhë në ato kushte të tregut që njihen si kushte të tregut *oligopol*. Nuk është e nevojshme që ndërmarrjet në fjalë të zbatojnë sjellje identike në çdo aspekt në treg. Ajo që ka rëndësi është se ata të jenë në gjendje të miratojnë një politikë të përbashkët në treg dhe të veprojnë në një masë të konsiderueshme në mënyrë të pavarur nga konkurentët e tyre, klientët e tyre dhe gjithashtu nga konsumatorët. Për qëllime praktike, në mënyrë që të përcaktohet ekzistenca e një ndërmarrje të tillë kolektive në treg, është e nevojshme të shqyrtohen faktorët që krijojnë një lidhje midis ndërmarrjeve në fjalë. Faktorë të tillë mund të rrjedhin nga natyra dhe kushtet e një marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve ose nga mënyra në të cilën ato marrëveshje zbatohen, me kusht që marrëveshja të bëjë që ato ndërmarrje të paraqiten ose të veprojnë së bashku si një ndërmarrje kolektive. Një rast i tillë mund të jetë, për shembull, nëse ndërmarrjet kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi e cila bën që ato të bashkërendojnë sjelljen e tyre në treg. Poashtu, një rasti i tillë mund të paraqitet nëse interesat pronësore dhe lidhjet e tjera ligjore i çojnë ndërmarrjet në fjalë të bashkërendojnë aktivitetet e tyre tregtare.

Në të njëjtën kohë, ekzistenca e një marrëveshjeje ose e marrëdhënieve të tjera ligjore nuk është e domosdoshme për gjetjen e një pozite dominuese të përbashkët. Kjo mund të bazohet në faktorë të tjerë ndërlidhës dhe varet nga një vlerësim ekonomik dhe, në veçanti, nga një vlerësim i strukturës së tregut në fjalë.

Edhe pse ndërmarrjet në tregjet oligopolistike ndonjëherë mund të jenë në gjendje të rrisin çmimet në mënyrë të konsiderueshme mbi

³ Gjykata Evropiane e Drejtësisë në Çështjen 85/76 Hoffmann-La Roche kundër Komisionit dhe Gjykata e Shkallës së Parë në Çështjen T-68/89 Italian Flat Glass, para. 358

nivelin konkurrues pa pasur nevojë për ndonjë marrëveshje të qartë ose praktikë të bashkërenduar, bashkërendimi ka më shumë të ngjarë të shfaqet në tregjet ku është relativisht e thjeshtë të arrihet një mirëkuptim i përbashkët përmes bashkërendimit. Sa më i thjeshtë dhe më i qëndrueshëm të jetë ambienti ekonomik, aq më lehtë është për ndërmarrjet të arrijnë një mirëkuptim të përbashkët. Në të vërtetë, ata mund të jenë në gjendje të bashkërendojnë sjelljen e tyre në treg thjesht duke vëzhguar dhe reaguuar ndaj sjelljes së njëri-tjetrit. Në disa tregje, bashkërendimi më i mundshëm mund të përfshijë bashkërendimin e drejtpërdrejtë të çmimeve për t'i mbajtur ato mbi nivelin e konkurrencës. Në tregje të tjera, bashkërendimi mund të synojë kufizimin e hyrjes së prodhimit ose të sasisë së kapaciteteve të reja në treg. Ndërmarrjet gjithashtu mund të bashkërendohen duke ndarë tregun, për shembull sipas zonave gjeografike ose karakteristikave të tjera të klientit, ose duke i ndarë kontratat midis tyre në tregjet e ofertave. Aftësia për të arritur dhe mbajtur një bashkërendim të tillë varet nga një numër faktorësh, prania e të cilëve shqyrtohet me kujdes në secilin rast:

- Çdo ndërmarrje duhet të jetë në gjendje të monitorojë nëse ndërmarrjet e tjera janë duke respektuar politikën e përbashkët. Nuk mjafton fakti se secila ndërmarrje është e vetëdijshme se një sjellje e ndër-varur në treg është fitimprurëse për të gjithë, sepse secila ndërmarrje do të tundohet të rrisë pjesëmarrjen e saj në treg duke devijuar nga strategjia e përbashkët. Prandaj, duhet të ketë transparencë të mjaftueshme në treg, në mënyrë që të gjitha ndërmarrjet e interesuara të jenë në dijeni, mjaft saktësisht dhe shpejt, për sjelljen në treg të të tjerëve.
- Zbatimi i politikës së përbashkët duhet të jetë i qëndrueshëm me kalimin e kohës, i cili presupozon ekzistencën e mekanizmave të mjaftueshëm parandalues, të cilët janë mjaft të ashpër për të bindur të gjitha ndërmarrjet e interesuara se është në interesin e tyre më të mirë t'i përmbahen politikës së përbashkët.
- Duhet të vërtetohet se kufizimet konkurruese nuk e rrezikojnë zbatimin e strategjisë së përbashkët. Sikurse në rastin e

dominimit të vetëm, duhet të analizohet se cila është pozita dhe forca që kanë në treg rivalët të cilët nuk bëjnë pjesë në ndërmarrjen kolektive, cili është pozita dhe forca në treg e blerësve dhe çfarë mundësie ka për hyrje të reja sipas indikacioneve nga shtrirja e pengesave për hyrje në treg.

Çfarë nënkuptohet me "në një treg të veçantë"?

Në ligjin e konkurrencës, fuqia e tregut vlerësohet në bazë të aktivitetit tregtar në një "treg relevant". Kjo do të thotë një treg për produkte të caktuara në një territor të caktuar gjeografik. Me fjalë të tjera, tregu relevant është një kombinim i tregut relevant të produktit dhe tregut relevant gjeografik. Tregu relevant i produktit është tregu për të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet që konsiderohen të këmbyeshëm ose të zëvendësueshëm nga konsumatori bazuar në karakteristikat e produkteve, çmimet e tyre dhe përdorimin e tyre të synuar. Nga ana tjetër, tregu relevant gjeografik përbën zonën në të cilën ndërmarrjet në fjalë janë të përfshira në furnizimin dhe kërkesën për produkte ose shërbime, dhe në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaft homogjene dhe mund të dallohen nga zonat fqinje sepse kushtet e konkurrencës në ato zona janë shumë të ndryshme⁴.

Për shembull:

(i) Tregu i qirasë për makineritë bujqësore në një lokalitet të caktuar mund të përbëjë një treg relevant për shkak të kostos për transportimin e makinerive me qira nga një lokalitet tjetër. Një biznes i vetëm në një lokalitet të tillë për dhënien me qira të makinerive të tilla mund, pra, të ketë një pozitë të rëndësishme dominuese në atë produkt dhe atë treg gjeografik.

⁴ Shikoni gjithashtu Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2011 (Tregu Relevant) në lidhje me mënyrën dhe kriteret për përcaktimin e tregut përkatës, i cili adopton pjesërisht njoftimin e Komisionit Evropian për përcaktimin e tregut relevant për qëllimet e ligjit të Komunitetit për Konkurrencën (GZ/C 372 e 9 dhjetorit 1997).

(ii) Një teatër i vetëm mund të mbajë një pozitë dominuese nëse mund të ngarkojë çdo çmim të biletës që ai zgjedh pa një ulje të konsiderueshme të kërkesës për bileta.

(iii) Dy furnizues të birrës mund të mbajnë një pozitë dominuese të përbashkët nëse bien dakord që secili të furnizojë vetëm në rajone të caktuara të vendit.

Për shkak se ndërmarrjet mund të përfshihen, në praktikë, në disa tregje (duke furnizuar produkte ose shërbime të ndryshme) dhe përqendrojnë veprimtarinë e tyre tregtare në nivele kombëtare, rajonale ose lokale, koncepti i dominimit të tregut duhet të vlerësohet në lidhje me një "treg relevant"

Abuzimet me pozitën dominuese në një treg të veçantë

Ekzistenca e pozitës dominuese për një ose më shumë ndërmarrjeve në një treg të veçantë është krejtësisht e ligjshme në Kosovë. Sidoqoftë, nëse kjo fuqi tregu abuzohet, mund të vendosen sanksione të forta nga AKK-ja. Siç u përmend më lart, kjo është për të siguruar një standard të lartë në sjelljen e ndërmarrjeve dominuese në mënyrë që konkurrenca e ndershme të mos priset dhe konsumatorët të mos dëmtohen nga fuqia e madhe në treg e ndërmarrjeve të caktuara.

Abuzimet në treg nga ndërmarrjet dominuese mund të marrin forma të ndryshme. Këto përfshijnë (por nuk kufizohen në) sjelljet e mëposhtme të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës:

- Përcaktimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes ose kushteve të tjera të padrejta për tregti;
- Kufizimi i prodhimit, tregjeve ose i zhvillimit teknologjik në dëm të konsumatorëve;

- Vendosja e kushteve diskriminuuese për ndërmarrjet e tjera duke i vendosur ato në një pozitë të pafavorshme për konkurrim;
- Rënia dakord për kontrata me kushte në mënyrë që pala tjetër ose palët kontraktuese të pranojnë detyrime shtesë të cilat, nga natyra e tyre ose sipas përdorimit tregtar, nuk kanë asnjë lidhje me objektin e kontratave të tilla;
- Përcaktimi i çmimeve ose kushteve të tjera, qëllimi ose efekti i të cilave është parandalimi i hyrjes ose përjashtimi i konkurrentëve të caktuar ose i njërit prej produkteve të tyre nga tregu relevant;
- Bllokimi i hyrjes në treg për ndërmarrjet e tjera duke refuzuar hyrjen në rrjet ose në infrastrukturat e ndërmarrjes me pozitë dominuese pa paguar një tarife të arsyeshme, nëse ky refuzim për të lejuar përdorimin e rrjetit ose infrastrukturave parandalon ndërmarrjen tjetër të veprojë si një konkurrent i ndërmarrjes në një pozitë dominuese.

Në përputhje me këta shembuj, shqetësimi kryesor është bllokimi i tregut ose detyrimi i një konkurrenti për të dalë nga tregu ose bllokimi i hyrjes në treg për konkurrentët e rinj. Bllokimi i tregut rezulton në më pak konkurrencë dhe çmime më të larta dhe mallra dhe shërbime me cilësi më të ulët për konsumatorët. Për më tepër, nuk është e nevojshme që të ekzistojë qëllimi për të abuzuar me pozitën dominuese sepse ajo që përbën një shkëlqje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës është kufizimi aktual ose i mundshëm i konkurrencës.

Rregullat e konkurrencës për abuzimet me pozitë dominuese në tregun e Kosovës rrjedhin nga ligji i Bashkimit Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka përkufizuar "abuzimin" me fjalët në vijim:

"është një koncept objektiv i cili ka të bëjë me sjelljen e një ndërmarrjeje në një pozitë dominuese, e cila është e tillë që ndikon në strukturën e një tregu, ku, si rezultat i vetë pranisë së ndërmarrjes në fjalë, shkalla e konkurrencës është dobësuar dhe e cila, përmes përdorimit të metodave të ndryshme nga ato që kushtëzojnë konkurrencën normale në produkte ose

shërbime në bazë të transaksionit të operatorëve tregtarë, ka efekt pengues në ruajtjen e nivelit ekzistues të konkurrencës në treg ose në rritjen e kësaj konkurrence.”⁵

Ky përkufizim nënkupton që sjellja në fjalë, nga natyra e saj, duhet të ketë aftësinë të përjashtojë konkurrentët nga tregu. Për të vërtetuar një aftësi të tillë, në përgjithësi është e mjaftueshme që të hetohet forma dhe natyra e sjelljes në fjalë. Së dyti, kjo nënkupton që, në kontekstin e tregut specifik, duhet të vërtetohet një efekt i mundshëm i shtrembërimit dhe bllokimit të tregut.

Abuzimet mund të jenë të bazuara në çmim dhe jo-në-çmim. Shembuj të abuzimeve të bazuara jo-në-çmim janë lidhjet kontraktuale, kontratat e një marke të vetme, refuzimi "i prerë" për të furnizuar dhe refuzimi i një qasjeje të arsyeshme nga një konkurrent në instalimet thelbësore (p.sh. në rrjetet ose infrastrukturat e kontrolluara nga një ndërmarrje dominuese). Në këto situata është e qartë se ndodh një "përjashtim" dhe se veprime të tilla mund të konsiderohen të jenë anti-konkurrese.

Disa lloje specifike të abuzimeve nga ndërmarrjet dominuese

Çmimet grabitqare. Ndërkohë që çmimet e ulëta zakonisht janë të mira për konsumatorët, nëse një ndërmarrje dominuese zbaton çmime aq të ulta sa që nuk i mbulon kostot e saj, kjo mund të çojë në eliminimin e konkurrentëve që janë po aq efikas sa ndërmarrja dominuese por që nuk mund të konkurrojnë mbi këtë bazë. Nga ana tjetër, kjo mund të çojë në çmime më të larta në një plan afatgjatë. Çmimi grabitqar (ndonjëherë i njohur si shitje me kosto më të ulët) mund të përbëjë një abuzim me një pozitë dominuese.

Marrëveshjet e markës së vetme lindin nga kushti që shpërndarësi të blejë produkte vetëm nga ndërmarrja dominuese dhe që të mos marrë furnizime nga burime të tjera, të cilat janë në konkurrencë me firmën dominuese. Në praktikë, kjo përfshin një ndërmarrje

⁵ Rasti 85/76 Hoffmann-La Roche kundër Komisionit Evropian.

dominuose të lidhur me blerësit (edhe nëse kjo është me kërkesë të tyre) përmes një detyrimi ose premtimi nga ana e tyre për të marrë të gjitha ose shumicën e kërkesave të tyre ekskluzivisht nga ndërmarrja dominuese.

Marrëveshjet lidhëse përfshijnë arritjen e kontratave të cilat varen nëse palët e tjera pranojnë detyrime plotësuese, të cilat për nga natyra e tyre ose përdorimi i synuar tregtar, nuk kanë asnjë lidhje me natyrën e kontratave të tilla. Kjo formë e sjelljes anti-konkurruese, në thelb, konsiston në transferimin e fuqisë së tregut të ndërmarrjes dominuese në një treg (produkti lidhës) në tregun ku ndërmarrja po hyn (produkti i lidhur). Me lidhjen e produkteve së bashku, ekzistojnë të paktën dy efekte negative:

- a) Konsumatorët nuk kanë mundësi ti blejnë produktet veç e veç; dhe
- b) Konkurruesit në tregun e produktit të lidhur janë të detyruar të konkurrojnë me tërë fuqinë e tregut të ndërmarrjes dominuese, e cila në fakt gjeneron eliminimin e tyre.

Disa shembuj të kësaj përfshijnë:

- lidhja e një ose më shumë produkteve me të gjithë gamën e produkteve duke përdorur zbritjet të përgjithshme, që do të thotë se zbritjet janë në dispozicion për të gjithë grupin e produkteve vetëm nëse ato blihen së bashku⁶.
- refuzimi për të furnizuar produktin lidhës nëse klienti nuk e blen produktin e lidhur.
- anulimi i garancisë për produktin lidhës nëse klienti nuk e blen produktin e lidhur.

Refuzimi për të furnizuar ose kërcënimi me refuzim të furnizimit nga kompanitë dominuese mund të përbëjë sjellje abuzive anti-konkurruese nga një ndërmarrje dominuese. Shembujt përfshijnë ndalimin e furnizimeve për të ndëshkuar blerësit për marrëdhëniet me konkurrentë të tjerë dhe refuzimin për të furnizuar blerësit që

⁶ Rasti 85/76 Hoffmann-La Roche kundër Komisionit.

nuk bien dakord për marrëveshje ekskluzive tregtie ose të lidhjes. Praktikrat e tilla normalisht nuk synojnë të përjashtojnë blerësin, por më tepër një konkurrent të ndërmarrjes dominuese. Normalisht, në mënyrë që shkëputja e një marrëdhënieje furnizimi të mund të deklarohet abuzive, duhet të plotësohen katër kushtet e mëposhtme:

- sjellja të mund të karakterizohet si duhet si shkëputje;
- ndërmarrja refuzuese është dominuese;
- refuzimi ka të ngjarë të ketë një efekt negativ në konkurrencë; dhe
- refuzimi nuk justifikohet objektivisht ose nga efikasiteti.

Mohimi i infrastrukturave thelbësore - Situata të tilla mund të paraqiten kur një kompani dominuese i mohon blerësit qasjen në një Infrastrukturë, për ta përjashtuar atë blerës nga pjesëmarrja në një aktivitet ekonomik (kjo nganjëherë njihet si "bllokim vertikal"). Edhe blerësi i përjashtuar mund të jetë vetëm një klient, problemet e konkurrencës lindin, në mënyrë tipike, kur firma e dëmtuar është gjithashtu një rival i kompanisë dominuese në aktivitetin ekonomik për të cilin nevojiten infrastruktura. Ky lloj i përjashtimit mund të mbulojë një gamë të gjerë praktikash, të tilla si shkëputja e një marrëdhënieje ekzistuese tregtare, refuzimi për të furnizuar produkte, për të siguruar informacion, për të licencuar të drejtat e pronësisë intelektuale ose për të dhënë qasje në një strukturë thelbësore ose një rrjet. Disa nga çështjet më të rëndësishme të ndjekura nga Komisioni Evropian dhe autoritetet e ndryshme kombëtare të konkurrencës në lidhje me mohimin e infrastrukturave thelbësore janë përqendruar në sektorin e telekomunikacionit, ku firma ekzistuese kishte një pozitë dominuese (ndonjëherë monopol) në rrjetin e bakrit dhe/ose kabllove për të lidhur internetin ose shërbime të tjera me shtëpitë e klientëve. Në shumë prej këtyre rasteve, ndërmarrja ekzistuese ose thjesht ka refuzuar qasjen në rrjet ose ka ngarkuar çmime për qasje që ishin më të larta se çmimet e shitjes me pakicë që vetë ata

po i ngarkonin (shtrydhje margjine), në mënyrë që të përjashtojë konkurrentët. Praktika të tilla si taktikat e vonimit të furnizimit, vendosja e kushteve të padrejta tregtare dhe ngarkimi i çmimeve të tilla që nuk është ekonomikisht e vlefshme për blerësin të vazhdojë aktivitetin e tij, gjithashtu mund të përbëjnë një refuzim të furnizimit.

AKK-ja dhe abuzimet e pozitive dominuese të tregut

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, AKK-ja pas një hetimi, mund të marrë një vendim që konstaton se një ose më shumë ndërmarrje kanë një pozitë dominuese në treg të Kosovës dhe kanë abuzuar me atë fuqi të tregut me anë të veprimtarisë abuzive të ndaluar me Ligj. Kjo i referohet, në veçanti, listës së abuzimeve të mundshme të shqyrtuara më sipër, por gjithashtu mund t'u referohet formave të tjera të sjelljes. Këto hetime të AKK-së mund të iniciohen nga vet AKK-ja ose në përgjigje të ankesave të pranuar nga komuniteti i biznesit ose nga konsumatorët.

Në raste të tilla, AKK-ja është e autorizuar të urdhërojë përfundimin e çdo sjelljeje abuzive të konfirmuar dhe të shqiptojë gjoba deri në 10% të qarkullimit të përgjithshëm të viti paraparak të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në fjalë.

Gjithashtu, në lidhje me propozimet për përqendrim të ndërmarrjeve, të cilat sipas Ligjit duhet të njoftohen dhe aprovohen, AKK-ja mund t'i ndalojë përqendrimet nëse ato mund të dëmtojnë ndjeshëm konkurrencën, veçanërisht kur një përqendrim do të rezultojë në forcimin e një pozite dominuese aktuale ose krijimin e një pozite të re dominuese.

Informacionet të mëtejshme

Për informacione të mëtejshme për politikën e konkurrencës në Kosovë, shihni broshurat e tjera në serinë e broshurave të AAK-së ***“Sigurimi i përfitimeve nga Konkurrenca e Drejtë”*** dhe vizitoni faqen tonë në internet: <https://ak.rks-gov.net/>



Funded by
the European Union



Kjo broshurë është përgatitur me ndihmën e Projektit të financuar nga BE: "Mbështetje e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore" menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe zbatuar nga një Konsorcium i B&S Europe

